Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale,
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv),
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit _____

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurimi i ofertes, **nuk kërkohet** (nëse është i zbatueshëm) sipas Shtojcës 3;
- b. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- c. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;
- ç. Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- d. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

3. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor),

3.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Dokumentat standarde të tenderit

1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë liçencë profesionale për ushtrim aktiviteti me objekt përpunim dhe shpërndarje ushqimi, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:


1. Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, 2015, 2016, 2017 ku vlera mesatare e xhiros gjatë 3 viteve të fundit të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.
2. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit 2014, 2015, 2016 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

3.3 Kapaciteti teknik

1. Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, shërbime të ngjashme në vlerën totale jo më pak se 40 % e fondit limit.

Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e lidhur si dhe vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin furnizimeve **dhe/ose**
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.



2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001-2008/ISO 9001-2015. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
3. Çertifikatë e shoqërisë ISO 22000:2005 - Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
4. Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 18001:2007. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Dokumentat standarde të tenderit

5. Çertifikatë e menaxhimit për sigurinë ushqimore - Analiza e rreziqeve dhe pikat kritike të kontrollit (HACCP). Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën ISO 14001:2004/ ISO 14001:2015 - Sisteme të menaxhimit të mjedisit. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
7. Operatori ekonomik duhet të disponojë ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit. Për të plotësuar këto pike operatori ekonomike duhet të paraqesë:
 - Dokumentacionin që verteton pronesinë ose marrjen me qera të këtij ambienti.
 - Leje e mjedisit e tipit C, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) për zhvillimin e aktivitetit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, për objektin në fjalë.
 - Leje higjeno - sanitare për objektin në fjalë.
 - Aktin Teknik persa i perket masave mbrojtëse të zjarrit.
8. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 2 (dy) mjete transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi apo të marrë me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës dhe të shoqëruar me lejen higjeno-sanitare, leje qarkullimi, akt kolaudimi dhe sigurimin e detyrueshëm të mjetit.
9. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 35 (tridhjetë e pesë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të gatimit, të siguruar për periudhën janar 2017 - dhjetor 2017. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:
 - Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën janar 2017 - dhjetor 2017.
 - Listepagesat (E-Sig 025) të vulosura nga Administrata Tatimore për periudhën janar 2017 - dhjetor 2017.
10. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjes me profesione si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1	Kuzhinier	3
2	Mercollog/Kimist/teknolog	2

Dokumentat standarde të tenderit

3	Ndihmes kuzhinierë/Shërbyes gatimi	15
	Total	20

11. Punonjësit në tabelën e mësipërme duhet të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë pune dhe të paraqesin dokumentacionin sipas profesioneve si më poshtë:

- Për kuzhinierin: diplome ose çertifikatë kualifikimi, kontrate pune, libeze pune.
- Për mercollogun/kimistin//teknologun: diplomë ose çertifikatë kualifikimi, kontrate pune, libeze pune.
- Për ndihmës kuzhinierë/Sherbyes gatimi: kontrata pune dhe librezat e punes.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.



Shtojca 9

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Shërbimi që kërkohet:

Kontrata që kërkohet të lidhet ka një natyrë të vecantë pasi nepermjet saj synohet të ofrohet shërbim në gatimin, transportin dhe servirjes e tij deri të shtrati i pacientit në Spitalin Universitar të Traumës, i cili është një spital me permasa të konsiderueshme që mbulon të gjithë Rajonin Tiranës e madje gjithë Shqipërisë.

Për nga natyra që ka ky spital, shërbimi i ushqimit që do të kryhet kërkon:

- Një investim fillestar të konsiderueshem dhe një investim në vazhdim për qarkullimin e inventareve të imta dhe paisjeve në përdorim për ofrimin e këtij shërbimi deri tek pacienti;
- Operatori i kontraktuar duhet të ofrojë shërbimin e ushqimit sipas të gjitha rregullave higjieno sanitare qësh nga lenda e parë, përgatitja, gatimi, paketimi, transporti,

Dokumentat standarde të tenderit

shperndarja dhe deri tek servirja tek shtrati i pacientit, per 7 (shtate) ditet e javes sipas vakteve te percaktara nga SUT dhe sipas kerkeses – porosise ditore te Kryeinfemiereve ne baze te numrit te pacienteve dhe dietave respektive te tyre;

- Punesimin e nje numri te konsiderueshem dhe profesional personeli per gatimin dhe servirjen e ushqimit ne pavion deri tek shtrati i pacientit;
- Monitorim te vazhdueshem te kushteve te realizimit te kontrates.

Duke pasur parasysh natyren spitalore, eshte e domosdoshme dhe e rendesishme, qe gjate orarit te shperndarjes dhe servirjes se ushqimit ne pavione te mos lejohet prania e njerezve te jashtem apo te afermeve te pacienteve ne menyre qe te shmanget kontamini i ushqimit dhe per te pasur nje performace ne rritje ne ofrimin e ushqimit tek pacientet.

Pergatitja e ushqimit ne cilesine e duhur ne baze te dietave e kalorive do te ndikonte ne uljen e diteqendrimit te pacienteve ne spital si dhe uljen e perdorimit te medikamenteve nga ana e tyre.

Operatori ekonomik privat qe do te kontraktohet, duhet te ofroje nje sherbim i cili do te perfshije:

- Pergatitjen dhe gatimin e ushqimit sipas kerkesave dhe dietave te percaktuara nga Spitali Universitar i Traumës, ne baze te kerkesave higjeno sanitare dhe standarteve te kerkuara;
- Paketimin dhe ambalazhimin sipas dietave dhe racioneve te kerkuara
- Transportin e ushqimit te gatuar deri tek pavioni sipas sherbimeve dhe orareve te servirjes;
- Shperndarjen e ushqimit te gatuar ne te gjitha sherbimet dhe pavionet e SUT,
- Servirjen ushqimit brenda te gjitha parametrave ne orarin e caktuar sipas dietave deri tek pacienti dhe mjeku roje ne sherbim 24 ore;

Sherbimi do te ofrohet gjate gjithe javes prej dites se hene deri ditën e diel sipas vakteve dhe flet porosise se Spitalit Universitar të Traumës si dhe shtesave te racioneve qe mund te jene te nevojshme gjate fundjaves por dhe sipas kerkeses se Kryeinfemiereve te pavionit ne rast te shtrimeve te reja dhe te paraportuar ne forcën ditore te cilat do te rakordohen me Sektorin e Burimeve Njerëzore.

Ne Spitalin Universitar të Traumës, do të zbatohen dietat ne baze te Urdherit Nr. 28 datë 09.02.1998 i Ministrit të Shëndetësisë si vijon :

Tabela 1

Nr.	Emertimi i dietes
1	Dieta Nr. 1 Normale
2	Dieta Nr. 2 (Hidrike A)
3	Dieta Nr. 2 (Hidrike B-1)
4	Dieta Nr. 2 (Hidrike B-2)
5	Dieta Nr. 3 (Dieta ne semundjet infektive)
6	Dieta Nr. 4 (Dieta e Lenget)
7	Dieta Nr. 5 (Dieta e qullet 1/2 e lenget)
8	Dieta Nr. 6 (Dieta Hepatopatike ne fazen akute dhe subakute)
9	Dieta Nr. 7 (Dieta Blanda)
10	Dieta Nr. 8 (Dieta per Ulcerozen - HIPKALORIKE dhe NORMOKALORIKE)

Dokumentat standarde të tenderit

11	Dieta Nr. 9 (Dieta per Enero-Kolite)
12	Dieta Nr. 11 (Dieta Hiperproteinike shume e varfer ne Na 20 g Proteina)
13	Dieta Nr. 12 (Dieta Diabetike e ekuilibruar)
14	Dieta Nr. 13 (Dieta NORMOKALORIKE shume e varfer ne Na)
15	Dieta Nr. 14 (Dieta HIPERKALORIKE, HIPERPROTEINIKE e pasur me CA e FE)
16	Dieta per mjek

Ne menyre te detajuar jepet ne vijim perberja e dietave qe zbatohen ne Spitalin Universitar të Traumës :

DIETAT

Dieta Nr. 1 Normale 2700 k kal (prot. 100g,
lipide 77 g, glucide 420)

Nr.	Asortimenti	Njesia matese	Sasia
1	Qumesht	ml	300
2	Sheqer	gr	15
3	Buke	gr	250
4	Oriz/Makarona	gr	150
5	Zarzavate	gr	500
6	Vaj	ml	30
7	Mish	gr	150
8	Fruta	gr	300
9	Djathe,gjize	gr	80
10	Gjalpe	gr	10

Public Health Sector

Dieta Nr. 2 (Hidrike A) 102 k kal (prot. 3.5,
lipide 9.8, glucide 0 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia matese	Sasia
1	Leng mishi	gr	1000
2	Djathe i grire	gr	10

Dieta Nr. 2 (Hidrike B-1) 392 k kal (prot. 0,
lipide 0, glucide 100 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia matese	Sasia
1	Leng frutash	gr	1000
2	Sheqer	gr	100

4 Dieta Nr. 2 (Hidrike B-2) 102 k kal

Nr.	Asortimenti	Njesia matese	Sasia
1	Uje	ml	1000
2	Sheqer	gr	100

Dokumentat standarde të tenderit

Dieta Nr. 3 (Dieta ne semundjet infektive) 2500
5 k kal (prot. 80, lipide 61, glucide 436 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia masese	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	200
2	Sheqer	gr	20
3	Recel/Prevede	gr	100
4	Oriz/Makarona	gr	130
5	Buke	gr	160
6	Vaj	gr	30
7	Gjalpe	gr	5
8	Mish	gr	140
9	Patate	gr	200
10	Zarzavate	gr	200
11	Djathe pa kripe	gr	100
12	Fruta	gr	400

Dieta Nr. 4 (Dieta e Lenget) 2100 k kal (prot.
6 70, lipide 95.3, glucide 248.6 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia masese	Sasia
1	Sheqer	gr	60
2	Miell orizi	gr	60
3	Vaj	gr	30
4	Mish	gr	60
5	Biskota	gr	20
6	krem qumeshti	gr	50
7	gelatin frutash	gr	50
8	Veze e fresket	kokerr	1
9	Fruta	gr	500

Dieta Nr. 5 (Dieta e qullet 1/2 e lenget) 2100 k
7 kal (prot. 80 g, yndyrna 12, glucide 297 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia masese	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	700
2	Sheqer	gr	60
3	Biskota	gr	100
4	Vaj	gr	30
5	Oriz	gr	50
6	Mish	gr	120
7	Patate	gr	200

Dokumentat standarde të tenderit

8	Fruta	gr	400
9	Djathe	gr	30
10	Veze	kokerr	1

Dieta Nr. 6 (Dieta Hepatopatike ne fazen akute dhe subakute) 2000 k kal (prot.90 g, yndyrna

8 50, glucide 322 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia matese	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	200
2	Sheqer	gr	15
3	Vaj	gr	10
4	Oriz/Makarona	gr	120
5	Mish	gr	160
6	Patate	gr	200
7	Zarzavate	gr	200
8	Buke	gr	120
9	Djathe	gr	100
10	Gjalp	gr	5

Dieta Nr. 7 (Dieta Blanda) 2000 k kal (prot.82 g, lipide 16, glucide 265 gr)

9

Nr.	Asortimenti	Njesia matese	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	1500
2	Sheqer	gr	20
3	Buke	gr	60
4	Oriz	gr	100
5	Gjalp	gr	20
6	Patate	gr	250
7	Veze	kokerr	1
8	Djathe i njome	gr	70

Dieta Nr. 8 (Dieta per Ulcerozen -

10 HIPOKALORIKE dhe NORMOKALORIKE)

A. HIPOKALORIKE 1800 k kal (prot.80 g, lipide 57, glucide 256 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia matese	Sasia
1	Qumesht/Kos	ml	400
2	Sheqer	gr	10
3	Zarzavate	gr	350
4	Oriz/Makarona	gr	100
5	Vaj	gr	15
6	Mish	gr	130
7	Fruta	gr	500

Dokumentat standarde të tenderit

8	Buke	gr	120
9	Djathe	gr	70

B. NORMOKALORIKE 1600 k kal (prot.99 g, lipide 90, glucide 370 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia masese	Sasia
1	Qumesht/Kos	ml	500
2	Sheqer	gr	20
3	Zarzavate	gr	500
4	Oriz/Makarona	gr	150
5	Vaj	gr	20
6	gjalpe	gr	20
7	Mish	gr	150
8	Fruta	gr	500
9	Buke	gr	120
10	Djathe	gr	100
11	ose veze	kokerr	2

Dieta Nr. 9 (Dieta per Enero-Kolite) 2000 k kal (prot.70 g, lipide 63, glucide 308 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia masese	Sasia
1	caj, leng frutash	ml	200
2	Sheqer	gr	10
3	Oriz	gr	130
4	gjalpe	gr	30
5	Mish	gr	100
6	Buke	gr	140
7	Djathe	gr	100
8	Patate,Karrote	gr	400
9	Fruta	gr	200

Dieta Nr. 11 (Dieta Hiperproteinike shume e varfer ne Na 20 g Proteina) 2000 k kal (prot.21 g, lipide 75, glucide 362 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia masese	Sasia
1	caj, leng frutash	ml	400
2	Sheqer	gr	40
3	Recel/marmalate	gr	100
4	Oriz/Makarona	gr	150
5	Veze	kokerr	1
6	Fruta	gr	400
7	Zarzavate	gr	200
8	Djathe	gr	30

Dokumentat standarde të tenderit

Dieta 12 (Diabetike e
ekujlibruar) 2300 k kal (prot.

13 88 g, lip. 92 gr, gluc. 278 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia masese	Sasia
1	Qumesht/Kos	ml	600
2	Buke	gr	150
3	Zarzavate	gr	500
4	Veze	kokerr	1
5	Djathe	gr	50
6	Gjalp	gr	20
7	Oriz	gr	100
8	Mish	gr	100
9	Vaj	gr	25
10	Frut	gr	500

Dieta Nr. 13 (Dieta NORMOKALORIKE
shume e varfer ne Na) 2200 k kal (prot.90 g,
lipide 64 g, glucide 336 gr)

14

Nr.	Asortimenti	Njesia masese	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	200
2	Mish	gr	100
3	Veze	kokerr	1
4	Gjize	gr	50
5	Vaj	gr	30
6	Gjalp	gr	10
7	Zarzavate	gr	400
8	Fruta	gr	350
9	Buke pa kripe	gr	160
10	Oriz	gr	130

Dieta Nr. 14 (Dieta HIPERKALORIKE,
HIPERPROTEINIKE e pasur me CA e FE)
3000 k kal (prot.122 g, lipide 108 g, glucide

15 385 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia masese	Sasia
1	Qumesht/Kos	ml	600
2	Mish	gr	200
3	Vaj	gr	30
4	Gjalp	gr	15
5	Djathe/gjize	gr	100
6	Veze	kokerr	1

Dokumentat standarde të tenderit

7	Sheqer	gr	30
8	Oriz	gr	110
9	Zarzavate	gr	500
10	Buke	gr	300
11	Fruta	gr	400

16 Dieta per mjek 4300 k kal

Nr.	Asortimenti	Njesia matese	Sasia
1	Buke gruri	gr	600
2	Oriz	gr	60
3	Makarona	gr	50
4	Fasule	gr	60
5	Mish vici	gr	200
6	Vaj per gatim	ml	30
7	Vaj per sallate	ml	10
8	Gjalp	gr	30
9	Sheqer	gr	50
10	Sallam/proshute	gr	50
11	Djathe I bardhe	gr	40
12	Qumesht	ml	300
13	Veze	kokerr	1
14	Perime per gatim	gr	350
15	Perime per sallate	gr	150
16	Fruta	gr	250
17	Recel	gr	30
18	Salce	gr	3
19	Caj mali	gr	1
20	Kripe	gr	10
21	Erza	gr	1

SPECIFIKIME TEKNIKE PËR SHËRBIMIN E KUZHINËS:

- Kapaciteti i kuzhinës duhet të jetë i përshtatshëm për prodhimin e të paktën 1500 racioneve në vakt për efekt të emergjencave.
- Ushqimi para shpërndarjes kontrollohet nga mjeku dietolog dhe nga mjeku i shërbimit.
- Operatori i kontraktuar, ne baze te kontrates, pergatit ushqimin ne menyre te perqendruar ne nje kuzhine per te gjithë pacientet e shtruar ne Spitalin Universitar të Traumës, bazuar ne percaktimin dietik te karteles se pacientit si dhe te verifikimit te forces ditore nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe me pas e shperndan deri tek shtrati i pacientit. Gjithashtu përgatit racionet e ushqimit për personelit mjekësor që ndodhet në shërbim 24 orësh (Dieta 4300 Kilo Kalori mjeku).

Dokumentat standarde të tenderit

- Operatori i kontraktuar e transporton ushqimin e përgatitur nga kuzhina deri ne pavion, per te gjithë te semuret dhe personelin ne sherbim, me mjetet, pajisjet dhe enet e veta si dhe po me mjetet e veta kryen shperndarjen deri tek shtrati i pacientit. Transporti realizohet nga subjekti sipërmarrës me enë të posacme (termuse) të llojeve dhe madhësive të ndyshme në funksion të sasisë që ofrohet si dhe për të ruajtur nivelin kulinar të ushqimit (e rëndësishme është ruajtja e nivelit të temperaturës).
- Të gjitha termuset dhe enët me të cilat transportohet ushqimi duhet të jenë detyrimisht me material inoksi dhe me mbyllje hermetike (për të siguruar mbrojtjen nga mjedisi i jashtëm).
- Spitali Universitar i Traumës, cakton dhoma te vecanta (minikuzhina) sipas nevojës, me qellim mbajtjen e inventarit dhe shperndarjen e ushqimit.
- Sipërmarrësi, brënda sipërfaqes se minikuzhinës realizon larjen dhe dezinfektimin e enëve dhe pajisjeve që përdoren brënda në pavion.
- Sipërmarrësi në këto ambjente (minikuzhina) konsumon ujë dhe energji elektrike për të cilat duhet të bëjë pagesat përkatëse sipas matësave që do t'i vendosi brënda këtyre ambjenteve.
- Enët që përdoren për shpërndarjen e ushqimit tek pacienti duhet të jenë me material jot ë dëmshëm për shëndetin. Ato nuk duhet të jenë plastike.
- Ushqimi ndahet brenda ne pavione, pa perfshire repartet e urgjences dhe repartet ditore ku nuk jepet ushqim.
- Operatori i kontraktuar përgatit racionet e ushqimit sipas nevojave kalorike te dietave të mësipërme, te numrit te te semureve te shtruar, si dhe te personelit mjekesor qe eshte ne sherbim 24 ore.
- Këto racione duhet të përgatiten në minikuzhina dhe të shpërndahen me karrela të lëvizshme me kate, të vendosen në tabaka të vecanta sipas dietave për cdo pacient. Ky ushqim duhet të serviret detyrimisht i mbuluar me qese plasmasi (rulon), për të ruajtur higjenen kulinare.
- Numri i te semureve del nga fletet e forces ditore qe plotesohen sipas kartelave nga Kryeinfermieret dhe Shefat e Sherbimeve te pavioneve dhe dorezohen ne Sektorin e Burimeve Njerëzore cdo dite, brenda ores 12.00.
- Sektori i Burimeve Njerëzore harton pasqyren permbledhese bazuar ne fletet e forces ditore duke shtuar edhe numrin e personelit mjekesor ne sherbim 24 ore. Kete pasqyre ia dorezon pergjegjesit te kuzhines te operatorit te kontraktuar cdo dite, brenda ores 13.00, per ditën e nesërme.
- Sektori i Burimeve Njerëzore, bazuar ne fletet e forces ditore, ne fillim te cdo muaji, harton pasqyren permbledhese me numrin e te semureve dhe personelit mjekesor sipas dietave per muajin paraardhes. Kjo pasqyre, pasi rakordohet, firmoset nga perfaqesuesit e te dy paleve dhe sherben si baze per kryerjen e pageses cdo muaj nga Spitali Universitar i Trumës per operatorin e kontraktuar.
- Operatori kontraktuar përgatit ushqimin sipas menuse te miratuar nga Spitali Universitar i Traumës, e ndan ne racione dhe e shperndan ne pavione 3 here ne dite: ne mengjes ne oren 7.00-8.00, ne dreke ne oren 11.30-12.30 dhe ne darke, ne oren 18.00-19.00.
- Operatori i kontraktuar zbaton kerkesat e ligjit Nr. 9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, per furnizimin me artikujt ushqimore ne brendesi te kuzhines si dhe per ruajtjen e higjenes te mjedisit dhe personelit.

Dokumentat standarde të tenderit

- Inventari i imet (pjata, luge, pirunj, tabaka etj.) janë prone e sipermarresit. Pastrimin i inventarit të imët kryhet nga kontraktori. Ne rast pacientesh me semundje infektive paisjet janë te vecanta dhe njeperdorimshe.
- Operatori i kontraktuar shperndan ushqimin per personelin mjekesor qe eshte ne sherbim 24 ore, ne vendet qe do te caktohen nga Spitali per kete qellim (mensa). Kuzhina per pergatitjen e ushqimit do jete ne ambjentet e siguruar nga vete sipermarresi. Te gjitha shpenzimet si energji elektrike, uje etj do perballohen nga vete sipermarresi kundrejt kontratave perkatese te furnizimit.
- Operatori i kontraktuar kryen pastrimin e mjediseve qe i jane vene ne dispozicion dhe heqjen e mbeturinave ne vendet e caktuara nga Spitali Universitar i Traumës.
- Operatori i kontraktuar shperndan ushqimin per cdo te semure dhe personel mjekesor me bazen materiale dhe pajisjet e minikuzhinave te siguruar me fondet e veta. Ai kryen gjithashtu edhe larjen dhe dizinfektimin e inventareve te imta dhe paisjeve qe perdoren brenda pavionit.

SUT do bëjë rivlerësimin e cmimit të kontratës në bazë të indeksit të inflacionit që do të publikohet cdo vit. Llogaritja e inflacionit do bëhet si vijon:

Vitin e dytë pas lidhjes së kontratës, do kërkohet indeksi i inflacionit nga INSTAT (muaji për të cilin do kërkohet indeksi i inflacionit do jetë ai i lidhjes së kontratës). Sipas të dhënave zyrtare që do merren nga INSTAT, do të rivlerësohet cmimi bazë i kontratës dhe cmimet e reja që do rezultojnë pas rivlerësimit, do ushtrohen përgjatë vitit të dytë.

Vitin e tretë pas lidhjes së kontratës, do kërkohet indeksi i inflacionit nga INSTAT (muaji për të cilin do kërkohet indeksi i inflacionit do jetë ai i lidhjes së kontratës). Sipas të dhënave zyrtare që do merren nga INSTAT, do të rivlerësohet cmimi i fundit i rivlerësuar (vitin e dytë) dhe cmimet e reja që do rezultojnë pas rivlerësimit, do ushtrohen përgjatë vitit të tretë.

Bazuar në sasinë e racioneve të llogaritur në mënyrë progresive për cdo vit, paraqesim tabelat **për cdo vit, per kater vjet si më poshtë**:

Viti 1 i kontratës

Nr	Pershkrimi i dietave	Sasia
1	Dieta Nr. 1 Normale	42,379
2	Dieta Nr. 2 Hidrike A	636
3	Dieta Nr. 2 Hidrike B-1	-
4	Dieta Nr. 2 Hidrike B-2	9
5	Dieta Nr. 3 Sëmundje Infektive	-
6	Dieta Nr. 4 e lëngët	5,857
7	Dieta Nr. 5 e qullët	20
8	Dieta Nr. 6 për hepatitët	-
9	Dieta Nr. 7 Blanda	-
10	Dieta Nr. 8 Per Ulcerozen	3,013
11	Dieta Nr. 9 Entero-kolitit	-

Dokumentat standarde të tenderit

12	Dieta Nr. 11 Hiperprot e varfër me Na	-
13	Dieta Nr. 12 Diabetike e ekuilibruar	3,227
14	Dieta Nr. 13 Norma kolike e varfër me Na	-
15	Dieta Nr. 14 Hiperprot. Hipergl e pasur me Ca e Fe	-
16	Norma 4300 k/kal per mjek	5,856


Viti 2 i kontratës

Nr	Pershkrimi i dietave	Sasia
1	Dieta Nr. 1 Normale	44,074
2	Dieta Nr. 2 Hidrike A	662
3	Dieta Nr. 2 Hidrike B-1	-
4	Dieta Nr. 2 Hidrike B-2	10
5	Dieta Nr. 3 Sëmundje Infektive	-
6	Dieta Nr. 4 e lëngët	6,092
7	Dieta Nr. 5 e qullët	21
8	Dieta Nr. 6 për hepatitët	-
9	Dieta Nr. 7 Blanda	-
10	Dieta Nr. 8 Per Ulcerozen	3,133
11	Dieta Nr. 9 Entero-kolitin	-
12	Dieta Nr. 11 Hiperprot e varfër me Na	-
13	Dieta Nr. 12 Diabetike e ekuilibruar	3,356
14	Dieta Nr. 13 Norma kolike e varfër me Na	-
15	Dieta Nr. 14 Hiperprot. Hipergl e pasur me Ca e Fe	-
16	Norma 4300 k/kal per mjek	5,856

Dokumentat standarde të tenderit

Viti 3 i Kontratës

Nr	Pershkrimi i dietave	Sasia
1	Dieta Nr. 1 Normale	45,837
2	Dieta Nr. 2 Hidrike A	688
3	Dieta Nr. 2 Hidrike B-1	-
4	Dieta Nr. 2 Hidrike B-2	10
5	Dieta Nr. 3 Sëmundje Infektive	-
6	Dieta Nr. 4 e lëngët	6,335
7	Dieta Nr. 5 e qullët	21
8	Dieta Nr. 6 për hepatitët	-
9	Dieta Nr. 7 Blanda	-
10	Dieta Nr. 8 Per Ulcerozen	3,259
11	Dieta Nr. 9 Entero-kolitin	-
12	Dieta Nr. 11 Hiperprot e varfër me Na	-
13	Dieta Nr. 12 Diabetike e ekuilibruar	3,490
14	Dieta Nr. 13 Norma kolike e varfër me Na	-
15	Dieta Nr. 14 Hiperprot. Hipergl e pasur me Ca e Fe	-
16	Norma 4300 k/kal per mjek	5,856

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Public Health Sector

Shërbim:

Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër

Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)



SHËRBIMET DHE GRAFIKULI EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Kryerja e Shërbimit të Gatimit dhe Shpërndarja e Ushqimit (Katering) ne Spitalin Universitar të Traumës”

Afatet e ekzekutimit: Per nje periudhe 3 (tre) vjecare nga data e lidhjes se kontrates.

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Shërbimi në gatimin, transportin dhe servirjes së ushqimit deri te shtrati i pacientit në pavionet e Spitalit Universitar të Traumës me qëllim sigurimin e ushqimit për pacientet e SUT sipas dietave të përcaktuara, sasise dhe Fondit Limit të përcaktuar nga AK.

Detyrat:

- Përgatitjen dhe gatimin e ushqimit sipas kërkesave dhe dietave të përcaktuara nga Spitali Universitar I Traumës, në bazë të kërkesave higjieno sanitare dhe standarteve të kërkuara;
- Paketimin dhe ambalazhimin sipas dietave dhe racioneve të kërkuara
- Transportin e ushqimit të gatuar deri tek pavioni sipas shërbimeve dhe orareve të servirjes;
- Shpërndarjen e ushqimit të gatuar në të gjitha shërbimet dhe pavionet e SUT,
- Servirjen ushqimit brenda të gjitha parametrave në orarin e caktuar sipas dietave deri tek pacienti dhe mjeku roje në shërbim 24 orë;

Shpërndarja: Shërbimi do të ofrohet gjatë gjithë javës prej ditës së hënë deri ditën e diel sipas vakteve dhe fletë porosise së Spitalit Universitar të Traumës si dhe shtesave të racioneve që mund të jenë të nevojshme gjatë fundjavës por dhe sipas kërkesës së Kryeinfermiereve të pavionit në rast të shtrimeve të reja dhe të raportuar në forcen ditore të cilat do të rakordohen me Sektorin e Burimeve Njerëzore.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Në ambjentet e Spitalit Universitar të Traumës

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Public Health Sector

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e

Dokumentat standarde të tenderit

shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____



[Titullari i autoritetit kontraktor] _____

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Dokumentat standarde të tenderit

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda **Public Health Sector** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen. _____

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES Shërbimet – Procedura e Hapur

Neni 1 Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës së hapur.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2 Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas

dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3 Hartimi i Kontratës

- 3.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikak Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit për Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

